REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr.251/1 Prot

Pustec, më 19.02.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr.2 Datë 19.02.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.101 DATË 24.12.2025 "MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS, NUMRIN E PUNONJËSVE DHE NIVELIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS DHE AGJENCISË SË BASHKISË PUSTEC PËR VITIN 2026

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 ''Për vetqeverisjen vendore'' i ndryshuar, neni 54 gërma(ç) ", ligjin 152/2013 "Për nepunësin civil",I ndryshuar, ligjin 7961 dt.12.07.1995 Kodi I Punës së Republikës së Shqiperisë, I ndryshuar, Vendimin Nr.325 ,datë 31.05.2023 'Për miratimin e structures së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvëndësministrit,funksionarëve të kabineteve,prefektit,nënprefektit,nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucuioneve të Administratës Publike",Vendimin nr.326, dt.31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialisteve të ndryshme në disa institucione te administrates publike", Vendimin nr.328 datë 31.05.2023''Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page,dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore ", Vendimin nr.240 dt.20.04.2023 Për një ndryshim në vendimin nr.419 date.26.06.2024,të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" Vendim Nr.104 date 11.02.2026 Per nje ndryshim ne vendim Nr.419 date 26.06.2024 te keshillit te ministrave,''Per miratimin e vlerave per secilin element perberes te pages bruto mujore te punonjesve te sherbimit te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi"dhe Vendimi Nr.127 date 27.02.2026 per disa ndryshime ne Vendimin nr.425 datë 26.06.2024''Për miratimin e strukturës së pagës së punonjëve mësimore në arsimin"si dhe në bazë të VKM Nr.776 datë 19.12.2025'Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi". I propozojmë Këshillit Bashkiak:

TË MIRATOJ

1. Miratimin e strukturës, numrit dhe nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Pustec për vitin ushtrimor 2026, sipas lidhjeve përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi..
2. Numri total i punonjësve të Bashkisë Pustec miratohet 110 (njëqind e dhjetë) punonjës, i shpërndarë si më poshtë:

    - Struktura e Administratës së Bashkisë 53 punonjës (Lidhja nr.1),
    - Struktura e Agjencisë së Shërbimit Publik 34 punonjës (Lidhja nr.2),
    - Arsimi parashkollor 8 punonjës (Lidhja nr.3),
    - Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH) 14 punonjës (Lidhja nr.4),

- Specialist i gjendjes civile, funksion i deleguar, 1 punonjës (Lidhja nr.5).

3. Niveli i pagave për çdo kategori, grup dhe funksion të përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas lidhjeve bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Sektori i Financës të ndjekë zbatimin e këtij vendimi, duke garantuar përllogaritjen e pagave në përputhje me aktet ligjore dhe mundësitë financiare të Bashkisë.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë, Sektori i Burimeve Njerëzore, Financës dhe njësitë përkatëse të administratës.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve ligjore.

PËRGJEGJËS I BURIMEVE NJERËZORE
Vasil STOJAN

KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC